



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.635/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë Kosovës -votave me postë, në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.03.2025, merr këtë:

## V E N D I M

**HUDHET E PASAFATSHME** ankesa A.nr.635/2025 e datës 07.03.2025 e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosjes (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, e parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë Kosovës – votave me postë, në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet rezultatet e votimit me postë dhe njëkohësisht ta urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin.

## A r s y e t i m

Me datë 07.03.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.635/2025 të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me të cilin pretendon se më 5 mars 2025, ditën e përmbylljes së procesit të numërimit dhe rinumërimit të fletëvotimeve, komisionerë dhe vëzhgues të Lëvizjes Vetëvendosje, kanë identifikuar se në vazhdimësi gjatë këtij procesi në Qendrën e Numërimit në Prishtinë, janë identifikuar parregullsi të shumta që provojnë qartazi se procesi i regjistrimit dhe i votimit përmes postës, respektivisht i plotësimit të fletëvotimeve, përveçse ka qenë në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore për zgjedhjet, gjithashtu ka vënë në pah mungesën e veprimit dhe shprehjes së vullnetit individual të votuesit ku gjatë procesit të numërimit të fletëvotimeve në QNR të dërguara më postë, kanë dalë në pah elemente të shumta që dëshmojnë qartazi për mosrespektim të dispozitave ligjore dhe kushtetuese të votimit. Përgjatë numërimit të secilës kuti në të cilat janë grumbulluar dhe ndarë fletëvotimet e dërguara përmes postës, janë identifikuar elemente të shumta që provojnë qartazi parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, numrat e kandidatëve të shënjuar në mënyrë të përqendruar, formën e fletëvotimeve, formën e shënjitimit të fletëvotimeve e të cilat më shumë i ngjasojnë votimit kolektiv, të personave të tjerë në emër të votuesve se sa votimit individual. Numërimi i këtyre fletëvotimeve në QNR ka shpalosur se fletëvotimet e dërguara përmes postës janë plotësuar në mënyrë të organizuar, duke cenuar kështu parimin e votimit individual dhe të

fshehtë. Siç do të dëshmohej edhe nga provat e bashkëngjitura, vërtetohet se kanë ekzistuar së paku pesë skema të mënyrës së votimit të veçuar nga dy elemente të përbashkëta. Këto pesë skema me numër të konsiderueshëm të fletëvotimeve për secilën skemë, ekspozojnë një mënyrë identike të votimit për nga mënyra e plotësimit (shenjimit) të fletëvotimit me shenjë të caktuar, si dhe për nga mënyra e votimit për numrat identik të kandidatëve të një subjekti të caktuar politik. Krejt kjo vërtetohet se procesi i votimit, respektivisht i plotësimit të fletëvotimeve, ka qenë një proces i përqendruar tek disa individë, i zhvilluar në mënyrë të organizuar si për nga mënyra teknike e shenjimit brenda katrorit të votimit për një subjekt të caktuar politik, po ashtu edhe për nga shënjimi i fletëvotimeve për kandidatët e caktuar të atij subjekti politik. Bazuar edhe në parimet e votimit, por edhe në praktikën e votimit në të gjitha zgjedhjet, por edhe në këto zgjedhje, madje edhe në fletëvotimet e pakontestuara të votimit përmes postës, është e kuptueshme që pavarësisht principeve ligjore mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimit, procesi i votimit është edhe akt autentik pothuajse për secilin votues. Ndërsa, në rastet e kontestuara, shihet qartë që mënyra e plotësimit të fletëvotimeve mbi atë se si është rrumbullakësuar numri brenda kornizës së votimit, apo vendosur shenja Tik apo X, janë identike për një numër të madh të fletëvotimeve, sikurse që varësisht për cilën skemë nga këto pesë skema, janë edhe numrat, respektivisht kandidatët e njëjtë që janë votuar. Madje është e dallueshme edhe brenda fletëvotimeve të të njëjtit subjekt politik kur bëhet fjalë për votat organike të këtij subjekti politik nga votat artificiale dhe të manipuluarat të po të njëjtit subjekt politik. Ky dallim është i qartë edhe për nga mënyra e plotësimit të fletëvotimeve edhe për nga përzgjedhja e kandidatëve. Për më tepër, edhe gjatë numërimit, vërehej qartë kur kishim të bëjmë për kontingjentin e këtyre fletëvotimeve të dallueshme për nga mënyra e votimit. Pothuajse në secilën nga kutitë ku haseshin të përqendruara këto fletëvotime, ato ishin të printuara/fotokopjuara njëllor, me ngjyrë ose bardh e zi, njëllor pa ndërprerje në mes të tyre, njëllor të plotësuarat e për kandidatët të njëjtë. Kjo dëshmonte jo vetëm faktin se janë plotësuar në mënyrë të organizuar, por edhe të shtypura e të dorëzuara po ashtu bashkërisht e në të njëjtën kohë. Nga informacionet për fazat e votimit përmes postës, që nga regjistrimi, votimi e dërgimi i pakove me fletëvotime, shihet qartë për një deformim përmes një ndërhyrje të organizuar.

Nga regjistrimi si votues jashtë Kosovës të qindra votuesve me një numër të njëjtë të telefonit, apo mospërputhja e qartë në mes të emrit dhe mbiemrit të votuesve me e-mail adresat, apo të adresave të pakuptimta të dhëna, që të gjitha bien në kundërshtim me Rregullën e KQZ-së dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e deri tek mënyra se si janë plotësuar fletëvotimet, flasin për një proces të manipuluar që cenon integritetin e procesit dhe deformon vullnetin e votuesve. Nga informatat tona të mbledhura dyshojmë që në listën e votuesve jashtë vendit janë rreth 1,700 persona të regjistruar me e-mail adresë që janë përdorur më shumë se katër (4) herë, kurse në dhjetëra raste deri në 22 herë. Po ashtu, evidentohet dhe dyshojmë se rreth 2,300 persona që janë regjistruar me të njëjtin numër telefoni që është përdorur më shumë se 4 herë, e në dhjetëra raste deri në 49 herë. Të gjitha këto pretendime mund të verifikohen dhe të konfirmohen në KQZ. Po ashtu, dyshohet për të dhëna për numrin (unik) të aplikimit që është i përsëritur shumë herë, megjithëse i njëjti mund të jepet veç një herë. Të gjitha këto mund të konfirmohen nga të dhënat që disponon KQZ. Këto parregullsi duket që janë edhe më të thella përgjatë secilës fazë. Sidoqoftë, provat e bashkëngjitura vërtetojnë mjaftueshëm se bëhet fjalë për një operacion të paligjshëm të votimit kolektiv, në mënyrë të njëjtë të lokalizuar në pesë skema dhe për kandidatët të njëjtë. Tutje, dallimi në rezultate për një subjekt politik jo vetëm me votat brenda vendit, por madje dallimi diametralisht edhe me rezultatet për të njëjtin subjekt politik apo për kandidatët në fjalë edhe në mesin e votave në përfaqësi diplomatike dhe rezultatit të votimit përmes postës (edhe pse po flasim për të njëjtën kategori të votuesve) shpërfaqin ndërhyrje të qartë në manipulimin e këtyre fletëvotimeve. Sa për ilustrim parregullsitë pikë së pari kanë të bëjnë me rritjen artificiale të LDK-së me mbi 400% krahasuar me votimin në përfaqësi

diplomatike. Ato bëhen edhe më serioze kur analizohen votat për kandidatin e kësaj partie si Hysen Çekaj, si dhe të disa kandidatëve tjerë. Derisa në Kosovë ai ka marrë 11,268 vota dhe vetëm 98 nga votimi në ambasada, pas numërimit të votave me postë ai renditet si kandidati i dytë më i votuar, me plot 12,000 vota vetëm nga votat e dërguara me postë. Në këto fletëvotime dallohet qartë një shabllon i përsëritur në disa skema: votat shkojnë për kandidatët me numër Lumir Abdixhiku 1, Kujtim Shala 2, Doarsa Kica Xhelili 3, Hysen Çekaj 80, ndërsa më pas kandidatëve të tjerë si: Bahrije Hyseni 99, Alban Zogaj 22, Gazmend Muhaxheri 5, Jeta Rafuna Hasani 45 dhe Fatmir Asllani 61. Kjo shpërputhje e votave bëhet edhe më e dukshme kur shikohet dallimi mes votave të LDK-së në komuna të caktuara, siç është rasti i komunës së Skenderajt, ku numri i votave përmes postës nga mërgata 497 e tejkalon numrin e votave të marra në Kosovë 419, shumë fletëvotime që përmbajnë votën për Çekajn dhe të tjerët duken si kopje identike, ngjashmëri kjo që ngre dyshime mbi autenticitetin e tyre. Ajo që bie në sy është fakti se përmes votimit në konsullatën e Shtutgardit, ku ai jeton, Çekaj ka arritur të sigurojë vetëm 33 vota. Ndërkohë, në të gjitha konsullatat e tjera në Gjermani, përfshirë ambasadën në Berlin, ai ka arritur t'i marrë 22 vota. Në ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike në shtetet e tjera, votat për Çekajn shkojnë deri në 5. Parregullsitë dhe ndërhyrjet janë evidente dhe qartazi duket për ndërhyrje gjatë regjistrimit të votuesve dhe në procesin e votimit me postë.

Për më tepër, mjafton të shikohen 10 kandidatët më të votuar, sipas secilës mënyrë votimi, për të nxjerrë përfundimin nëse vërtetë kemi të bëjmë me votë reale si rezultat i rritjes organike, apo kemi të bëjmë me votë të manipuluar. Kur e bëjmë këtë krahasim, del se 10 kandidatët më të votuar, sipas votave në ambasada dhe votave me postë përputhen si vijon: Për Lëvizjen VETËVENDOSJE! ka përputhje, për PDK ka përputhje, Për LDK ka vetëm 40% përputhje Pra, tek Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe tek PDK, vërehet që kemi të bëjmë me trupën e njëjtë të votuesve organikë, sepse votat kanë ndjekur kryesisht kandidatët e njëjtë me pjesën tjetër të elektoratit, qoftë me ata në Kosovë, qoftë me ata që kanë votuar në ambasada. Kurse tek 10 kandidatët më të votuar të LDK-së, vetëm 4 sosh dalin të jenë vazhdimësi e trupës votuese që ka votuar në ambasada, kurse tjerët janë persona që nuk gjenden në top 10-shen e votuesve të diasporës apo edhe votuesve të rregullt.

Kjo dëshmon që në rastin e votave me postë për LDK-në, nuk kemi të bëjmë me trupën votuese të LDK-së, por me një dorë tjetër, e cila për shkak të mbiproporcionalitetit të keqpërdorimit, e bën të mundshëm edhe identifikimin e skemës madje. Shihet qartë që dora që ka mbushur shumicën e fletëvotimeve me postë, për subjektin LDK, nuk paraqet në asnjë formë vazhdimësinë e trupës votuese për këtë subjekt. Sepse "patterni" i votës është krejtësisht tjetër. Me konkretisht, shembull, në fletëvotimet nga vendvotimi me numër VP/26/04, të vlefshme kanë qenë 359 fletëvotime ndër të cilat, 126 për LDK-në dhe 78 prej tyre për kandidatin Hysen Çekaj. Në këto fletëvotime vërehet që kanë qenë diku 5 duar të njëjta që kanë plotësuar fletëvotimet e tilla, duke vendosur brenda katrorëve më të njëjtin shënjes (kimik/ stilolaps), me ç'rast brenda katrorëve, herë kanë shënuar shenjën X herë atë Tik, e herë atë me rrumbullaksim për subjektin politik LDK dhe kandidatët e këtij subjekti. Po ashtu më vendvotimin me numër VP/ 19/06, nga gjithsej 175 vota të fituara nga LDK, 145 janë për kandidatin Hysen Çekaj. Po ashtu, edhe në fletëvotimet të cilat kanë marrë dhe posedojmë si mostër/ provë, shembull fletëvotimet nga vendvotimet me numër VP/ 26/ 01, VP/ 25/ 04, VP/ 30/ 03, V1)/ 25/02, VP/30/06, VP/19/06, VP/24/05, V1)/ 20/14, V1)/ 20/12 si dhe video CD me numrat përkatës VP/ 03/03, VP/ 20/11, VP/ 20/14 që dëshmojnë procesin e tillë manipulues. Pra, nga provat e tilla, vërehen qartazi që kandidatët e LDK-së Hysen Çekaj dhe kandidatët tjerë të lartshënuar, kanë marrë vota në disproporcion të jashtëzakonshëm me votat që kanë fituar nga procesi i votimit të rregullt dhe ato në përfaqësitë diplomatike. Pra të gjitha këto fletëvotime, disa janë të kopjuara dhe të printuara në mënyrë unike, të plotësuara nga grup i personave të njëjtë të cilët kanë cenuar rëndë integritetin e procesit zgjedhor për sa i përket votave të ardhura jashtë Kosovës me postë. Duke marrë për bazë të gjitha këto mostra dhe fakte e prova të paraqitura si me lartë, si dhe duke marrë për bazë të gjitha gjetjet të cilat

janë vërejtur/ identifikuar nga komisioneret dhe vëzhguesit e të cilat është e pamundshme që të gjitha t'i bashkëngjiten kësaj Ankese, konsiderojmë se votime të tilla kolektive të mirë organizuara nga një grup i personave të njëjtë në emër të qytetarëve të cilët jetojnë jashtë Kosovës, ka në të gjitha kutitë e votimit për fletëvotimet e ardhura me postë. Pra se procesi i votimit me postë ka qenë i manipuluar, dëshmohet qartë që nga fillimi duke e ditur se në listën e votuesve jashtë vendit janë rreth 1,700 persona të regjistruar me e-mail adresa që janë përdorur më shumë se katër (4) herë, kurse në dhjetëra raste deri në 22 herë. Po ashtu, siç është theksuar edhe me lart, janë identifikuar rreth 2,300 persona që janë regjistruar me të njëjtin numër telefoni që është përdorur më shumë se 4 herë, e në dhjetëra raste deri në 49 herë. Të gjitha këto pretendime mund të verifikohen dhe të konfirmohen në KQZ. Kësisoj që nga procesi i regjistrimit e deri të plotësimi i fletëvotimeve dhe dërgimi i tyre me postë, kaq qenë i mirë organizuar nga një grup personave të njëjtë, të cilët kanë votuar në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës të cilët jetojnë jashtë Kosovës. Ky organizim i tillë i votimit, unik dhe i mirë organizuar në formë manipuluese, nuk ka qenë i mundur të ndodhte pa një organizim, koordinim dhe bashkëveprim me deputetet e LDK-së të lartshënuar të cilët kanë marrë vota në disporporcion të jashtëzakonshëm me votat nga procesi i rregullt votues dhe ato në përfaqësitë diplomatike. I tërë ky argumentim logjiko - juridik, jep bazë të mjaftueshme që procesi i votimit me postë në tërësi, ka qenë i manipuluar në raport me votat të cilat i kanë shkuar subjektit politik LDK dhe kandidatëve të këtij subjekti. Prandaj duke e ditur që në secilin fletëvotim të ardhur me postë ka pasur manipulime të tilla, është dëmtuar integriteti zgjedhor, është cenuar e drejta e votimit siç përcaktohet në Kushtetutë dhe Ligj, prandaj në bazë të nenit 120 të LZP-së, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, ndërlidhur me nenet 101 dhe 106 të LZP-së, kërkojmë nga PZAP që të anulojë rezultatet e votimit me postë dhe njëkohësisht ta urdhërojë KQZ-në që të përsërisë votimin.

Si prova kanë bashkëngjitur fletëvotimet nga vendvotimet e tilla dhe CD dhe fletëvotimet nga vendvotimet përkatëse

Në përgjigje në ankesë nga KQZ tregohen në mënyrë kronologjike periudha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës e ku theksohet se pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, shqyrtimi i aplikacioneve për regjistrim është bërë deri me datën 28 dhjetor në orën 15:55, rrjedhimisht KQZ ka pranuar kundërshtimet administrative për procesin e regjistrimit deri me datë 29.12.2024 në ora 15:55. Gjatë periudhës së kundërshtimit, janë aprovuar 21 kërkesa për kundërshtim administrativ, të votuesve të cilët ishin refuzuar dhe të cilët janë aprovuar gjatë periudhës së regjistrimit, janë aprovuar po ashtu 151 kërkesa për anulimin e regjistrimit dhe kthimin në listën e votuesve brenda Kosovës si dhe janë hedhur si të palejuara 179 kundërshtime. KQZ me datë 30 dhjetor 2024, ka marrë vendim për aprovimin e 137 kërkesave për kundërshtim të cilët kishin dërguar dëshmitë gjatë kundërshtimit, në mungesë të cilave ishin refuzuar gjatë shqyrtimit të aplikimeve për refuzim. I pakënaqur me vendimin e KQZ-së, një votues ka parashtruar ankesë në PZAP me datë 30.12.2024, dhe PZAP me datë 03.01.2025 ka marrë vendim për refuzimin e ankesës. KQZ, me datë 04.01.2025, me vendimin numër 01/19-2025, ka certifikuar Listën e Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, që janë mbajtur me datë 9 shkurt 2025.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se:

**- Ankesa është e pasafatshme.**

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në vazhdimësi gjatë këtij procesi në Qendrën e Numërimit të Rezultateve në Prishtinë, kanë identifikuar parregullsi lidhur me procesin e regjistrimit dhe votimit përmes postës janë të pasafatshme.

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në listën e votuesve jashtë vendit janë të regjistruar persona me e-mail adresa që janë përdorur më shumë se katër (4) herë, dhe persona që janë regjistruar me të njëjtin numër telefoni që është përdorur në shumë se 4 herë, si dhe pretendimet ku dyshohet për të dhëna për numrin (unik) të aplikimit që është i përsëritur shumë herë, megjithëse i njëjti mund të jepet veç një herë, Paneli gjeti se pretendimet e paraqitura për këtë çështje janë të parashtruara pas afatit ligjor për ankimim, pasi që pala ankuese këto parregullsi ka mundur ti paraqes në momentin kur ka kuptuar për shkeljet e tilla ashtu siç parashihet me nenin 10 dhe 98 të LZP-së, ndërsa KQZ me datë 04.01.2025, me vendimin numër 01/19-2025, ka certifikuar Listën e Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2025, që janë mbajtur me datë 9 shkurt 2025, pra gjatë gjithë kësaj periudhe kohore pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë ankesë për parregullsitë e pretenduara rreth listës së votuesve me post të cilët kanë aplikuar për tu regjistruar, e rrjedhimisht ka lëshuar afatin ligjor prej 48 orëve për të kontestuar vendimin e KQZ-së për certifikimin e listës përfundimtare të votuesve të datës 04.01.2025, në PZAP.

Ndërsa pretendimet e parashtruesit të ankesës se në Qendrën e Numërimit të Rezultateve në Prishtinë, kanë identifikuar parregullsi lidhur me votimin përmes postës respektivisht parregullsitë e evidentuara mbi mënyrën e plotësimit të fletëvotimeve, numrat e kandidatëve të shënuar në mënyrë të përqendruar, formën e fletëvotimeve, formën e shënimit të fletëvotimeve e të cilat më shumë i ngjasojnë votimit kolektiv, të personave të tjerë në emër të votuesve se sa votimit individual, për Panelin këto pretendime janë të paraqitura pas afatit të paraparë ligjor për tu ankimuar.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa është e parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e saj, pasi që në njoftimin e KQZ-së i publikuar në web faqen e saj ndër të tjera thuhet se *“...Prishtinë, 04 mars 2025, 16:00 – Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është përmbyllur numërimi i fletëvotimeve nga votimi me postë jashtë Kosovës, i cili kishte filluar me 28 shkurt...”* ndërsa pala ankuese gjegjësisht subjekti politik LVV ankesën e ka dorëzuar në PZAP me datën 07 mars 2025 në ora 20:20 minuta që do të thotë se ankesa për këto pretendime është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor prej 48 orëve bazuar në nenin 105 paragrafi 1 i LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se : *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Paneli gjeti se e njëjta është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 105 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16 të Rregullës 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr. 635/2025 më datën 09.03.2025

Kryesuesi i Panelit,  
Bujar Muzaqi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.